



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:281618

Datë: 14.02.2022

Numri i dokumentit: 02709628

P.nr. 1019/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjyquese, Luljete Shabani, me praktikanten Magribe Avdili, në lëndën penale ndaj të akuzuarve E.H, dhe E.S, për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr.1766/2021, e datës 14.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik, më datën 27.01.2022, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndërsa, më datë 31.01.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari **E.H**, i lindur më datë ..., nga babai I. H. dhe nënës M.H., e gjinisë Z., me vendbanim në Gjilan, rr. “” nr. 24, me numër personali ... i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtorë në “.”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
2. I akuzuari, **E.S**, i lindur me datë .., nga babai H. S. dhe nënës G.S., e gjinisë K., me nr. personal ..., me vendbanim në Gjilan, .. i pamartuar, ka te kryer shkollën e mesme, punonë në kafiterin “M...”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse, më datën 04.08.2021, rreth orës 19:00 min. në Gjilan në . pas një mosmarrëveshje që kishin pas në komunikacion me të dëmtuarin F. K, të njejtit edhe i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari kishte qenë duke lëvizur me automjetin e llojit “...”, ngjyrë e zezë, me tabela te regjistrimit ..., me të arritur në rrugën F. J., takohet me të pandehurit E.H dhe E.S, të cilët kishin qenë me trotinet dhe skuter elektrik, me ç’rast ndalen dhe fillojnë të komunikojnë verbalisht mes vete, e më pas i pandehuri E. e godet të dëmtuarin

në këmbë në pjesën e barkut, ndërsa i pandehuri E. e godet të dëmtuarin me shqelma në pjesën e pasme në shpinë, të cilit i shkaktojnë lëndime trupore, i cili për shkak të lëndimeve të pësura detyrohet të kërkojë ndihmë mjeksore në Emregjencën e Spitalit Regjional Gjilan, sipas raportit mjekësor me numër të protokollit nr. ... të datës, 04.08.2021.

-me çka kanë kryer vepër penale **Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185, parag. 1 nënpar. 1.4 lidhur me nenin 31 i KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

DËNIM ME GJOBË

1. E.H i shqiptohet **Dënimi me Gjobë** në shumën prej **200 (dyqind) €**, të cilën gjobë do ta paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobë do të të zëvendësohet me dënim burgu, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

2. E.S, i shqiptohet **Dënimi me Gjobë** në shumën prej **200 (dyqind) €**, të cilën gjobë do ta paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobë do të të zëvendësohet me dënim burgu, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohen të dy të akuzuarit që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga **20 (njëzetë) €**, secili veç e veç, si dhe shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike **udhëzohet në kontest juridiko-civil**.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II nr.1766/21, të datës 14.12.2021, kundër të akuzuarve E.H dhe E.S, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen me dënim meritor sipas ligjit.

Meqenëse të akuzuarit E.H dhe E.S, e pranuan fajsinë për veprën penale e cila u vihet në barrë, i cili pranim është bërë pa presion, me vullnet të lirë, të njoftuar nga gjykata lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajsisë, i cili pranim është në përputhje edhe me provat tjera shkresat nuk pati nevojë të shtjellohen prova të tjera

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara konform nenit 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese pati parasysh se është hera e parë që ata kanë rënë ndesh me ligjin, pendimin dhe premtimin se më nuk do të përsërisin

ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa, si rrethana rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, peshën e veprës penale, andaj, u shqiptoi një dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me qëllim që me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK -së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1019/2021, më datë 31.01.2022**

Praktikantja
Magribe Avdili

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj Gjykate.